



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 117, datë 27.10.2022

PËR
MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË KUSHTËZUAR TË BUXHETIT TË
SHTETIT PËR EMERGJENCAT CIVILE, QË I ËSHTË ALOKUAR BASHKISË
DURRËS PËR VITIN 2022

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 “Per financat e veteqeverisjes vendore”, Ligjit Nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, të Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM nr.414, datë 8.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit te fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022” dhe në zbatim të shkresës së Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile Nr.1007/1, datë 17.6.2022, protokolluar në Bashki me nr. 5566, datë 21.06.2022, dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e MZSH, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për emergjencat civile, që i është alokuar Bashkisë Durrës për vitin 2022, sipas tabelës së mëposhtëme:

Nr.	Njësia zbatuese	Program buxhetor	Art.	Emërtimi i projektit	Vlera në lekë
1	Bashkia Durrës	03280	602	Aparat frymëmarrje për mbrojtjen nga gazi dhe tymi helmues i kompletuar me maskë (10 copë)	2,940,000
2	Bashkia Durrës	03280	602	Aspirator / Ventilator tymi (1 copë)	120,000
3	Bashkia Durrës	03280	602	Tuba për të luftuar zjarrin me diameter 50 mm dhe gjatësi 20 metra 50 copë, me diameter 70 mm dhe gjatësi 20 metra 10 copë dhe hedhëse uji profesionale (6 cope)	2,760,000
4	Bashkia Durrës	03280	602	Kostume zjarrduruese, (Xhakete, pantallona, kapuçe, çizme, helmete ,doreza)(36 komplete)	10,584,000
6	Bashkia Durrës	03280	602	Uniforma pune per nivelin baze dhe te mesem sipas VKM nr 1153, datë 24.12.2020	4,080,000
7	Bashkia Durrës	03280	231	Pompa portative me karel për largim ujrash te kapacitetit të lartë me diesel	1,920,000
8	Bashkia Durrës	04240	230	Hartimi i planeve të gadishmërisë së emergjencave të digave, hartimi i pashaportave të digave dhe hartimi projektpreventivave për reabilitim të digave	12,000,000
9	Bashkia Durrës	03280	606	Fond për dëmshpërblimin e banorëve, për dëmet që i janë shkaktuar banesave të tyre nga përmytja apo zjarri.	10,103,504
				TOTALI	44,507,504

- Miratimin e listës së banorëve (familjeve), që do të dëmshpërblehen për dëmet që i janë shkaktuar banesave të tyre nga përmytja apo zjarri, si dhe masës së dëmshpërblimit që do të përfitojnë sipas listës nr.1, bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- Fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për emergjencat civile, mbetur pa shpërndarë në vlerën 7 476 827.06 (shtatë milion e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e njëzetë e shtatë lekë e gjashtë qindarka) do të përdoret me vendime të veçanta të Këshillit Bashkiak.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria Ekonomike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 28.10.2022



Lista nr.1

LISTA E BANORËVE (FAMILJEVE) QË DO TË DËMSHPËRBLEHEN PËR DËMET QË I JANË SHKAKTUAR BANESAVE TË TYRE NGA PËRMBYTJA APO ZJARRI, SI DHE MASA E DËMSHPËRBLIMIT PËR SECILIN.

Nr	Emër Mbiemër	Shkaku i fatkeqësisë	Vlera përfituese në lekë
1	Drita Rapi	përmbytje	436,000
2	Skender Llapi	përmbytje	381,000
3	Artur Llapi	përmbytje	493,000
4	Merita Mullaj	përmbytje	505,000
5	Xhuljeta Estrefi	përmbytje	328,000
6	Gjuze Haliti	përmbytje	295,000
7	Besnik Beli	përmbytje	146,000
8	Kujtim Dervishi	përmbytje	127,000
9	Avdyl Hajdaraj	përmbytje	453,000
10	Meme Peku	përmbytje	337,000
11	Loreta Lipa	përmbytje	408,000
12	Tahir Roma	përmbytje	321,000
13	Aferdita Zoto	përmbytje	437,000
14	Shpresa Peshkepia	përmbytje	418,000
15	Miri Peshkepia	përmbytje	414,000
16	Shpetim Vezi	përmbytje	421,000
17	Ramazan Jaho	përmbytje	454,000
18	Gezim Hajdaraj	përmbytje	463,000
19	Frederik Kosollari	përmbytje	484,000
20	Refik Çiku	përmbytje	322,000
21	Zeqir Troshka	përmbytje	292,000
22	Edmond Vathi	përmbytje	519,000
23	Skender Falli	përmbytje	340,000
24	Marius Bodlli	Zjarr	399,000
25	Elez Furriku	Zjarr	476,000
26	Sabri Roda	Zjarr	434,504
Total vlera			10,103,504



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 834 /19 prot.

Durrës, më 10.11.2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.117 datë 27.10.2022 :

Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për emergjencat civile që i është alokuar Bashkisë Durrës për vitin 2022.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
EMILJAN JANI

